

- одбие да потпише индивидуален план за вработување во согласност со овој закон,
- исполни услови за пензија,
- на странец му истече важноста на личната работна дозвола,
- започне да врши занаетчиска, земјоделска, сточарска или друга дејност,
- одбие работно ангажирање за вршење на јавни работи и
- замине на отслужување на доброволен воен рок.

Учеството во програми за активна политика за вработување не е причини за бришење од регистарот на невработени, освен во случаи кога лицето зема учество во програма за активна политика за вработување која води до склучување на договор за вработување, лицето останува во регистарот на лица кои учествуваат во програми за активна политика за вработување.

Член 61-е

Агенцијата го брише лицето од регистарот на невработени лица или од регистарот на лица кои учествуваат во програми за активна политика за вработување, по службена должност со денот на настапување на некоја од причините од членот 61-ѓ од овој закон.

Доколку лицето учествува во програми за активна политика за вработување, спроведувањето на програмата се надгледува се до истекот на договорот за учество во програмата или до завршување на постапката за поврат на средствата, согласно со договорот за учество во програмата и покрај бришењето од евиденцијата.

Член 61-ж

Агенцијата го брише од регистарот лицето кое бара работа доколку:

- се одјави од регистарот и
- не стапи во контакт со Агенцијата во рок од шест месеци по пријавувањето."

Член 8

Постоечките агенции за посредување за вработување се должни да го усогласат своето работење со овој закон во рок од шест месеци од денот на влегувањето во сила на актот од членот 27-б став 2 од овој закон.

Член 9

Во членот 75 ставот 1 се менува и гласи:

"Исплатата на паричен надоместок на невработено лице се запира за време:

- на отслужување на доброволен воен рок,
- додека е во притвор или издржување на казна затвор до шест месеци;
- додека невработеното лице привремено престојува надвор од Република Македонија до 12 месеци, а претходно писмено ја известил Агенцијата,
- работно ангажирање над 30 дена за вршење на јавни работи и
- работно е ангажирано или врши дејност."

Член 10

Во членот 100 по ставот 2 се додава нов став 3, кој гласи:

"Глоба во износ од 200 евра во денарска противвредност ќе му се изрече за прекршок на самото место на невработеното лице кое од страна на инспекцискиот орган ќе се затекне да работи спротивно на законот (член 59-а став 6)."

Ставот 3 станува став 4.

Член 11

Подзаконските акти од членовите 61 став 2 и 27-б став 2 од овој закон ќе се донесат во рок од три месеци од денот на влегувањето во сила на овој закон.

Законот за евиденциите од областа на трудот ("Службен весник на Република Македонија" број 16/2004, 102/2008 и 17/11) и Правилникот за водење на евиденциите во областа на трудот ("Службен весник на Република Македонија" број 16/2004, 102/2008 и 15/2009) ќе се усогласат со одредбите на овој закон во рок од три месеци од денот на влегувањето во сила на овој закон.

Член 12

Се овластува Законодавно-правната комисија на Собранието на Република Македонија да утврди прецистен текст на Законот за вработувањето и осигурување во случај на невработеност.

Член 13

Овој закон влегува во сила осмиот ден од денот на објавувањето во „Службен весник на Република Македонија“, а ќе започне да се применува по истекот на три месеци од денот на влегувањето во сила на овој закон.

L I G J

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTESIMIN E LIGJIT PËR PUNESIM DHE SIGURIM NË RAST TË PAPUNESISE

Neni 1

Në Ligjin për punesim dhe sigurim në rast të papunesise ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonise" numer 37/97, 25/2000, 101/2000, 50/2001, 25/2003, 37/2004, 4/2005, 50/2006, 29/2007, 102/2008, 161/2008, 50/10, 88/10, 51/11 dhe 11/12), neni 2 ndryshohet si vijon:

"Nocionet e perdorura në kete ligj e kane kuptimin si vijojne:

- "punedhenes" eshte personi juridik ose njesia e tij organizative, që ka seli në territorin e Republikës së Maqedonise ose personi fizik, i cili ka qendrim të perhershëm në territorin e Republikës së Maqedonise, që punesojne punetore (në tekstin e metejme: punedhenes),
- "person i vetepunesuar" eshte personi fizik i cili kryen veprimtari ekonomike ose sherbim profesional apo sherbim tjetër intelektual, prej të cilit realizon të ardhura, për llogari të vet, në kushtet e percaktuara me ligj,
- "bujk" eshte personi i cili merret me veprimtari bujqesore dhe ka lidhur sigurim të detyrueshem social në pajtim me rregullat që e rregullojne kete sferë,
- "person i papunesuar" eshte personi që nuk eshte i punesuar, në menyre aktive kerkon pune dhe i ploteson kushtet e parapara me kete ligj,

- "person tjetër që kërkon punë" është personi ekonomikisht aktiv apo joaktiv, i cili evidentohet në Agjenci, por nuk kërkon punë në mënyrë aktive dhe/ose nuk është i gatshëm të pranojë punë,

- "person tjetër që kërkon punë për shkak të punësimit të rrezikuar" është personi që kërkon punë gjatë afatit të pushimit nga puna në rast të prishjes së marrëveshjes për punësim nga punedhësi, personi me vend punë të cilit i është anuluar marrëveshja për punësim për shkaqe afariste (teknologjike, ekonomike, organizative etj.), që vertetohet përmes shikimit në dokumentacionin e punedhësit ose personi që ka lidhur marrëveshje për punësim në kohë të caktuar dhe marrëveshja për punësim e të cilit skadon më së shumti për tre muaj,

- "kompensim në para për persona të papunësuar" është kompensimi për humbjen e rrogës ose të ardhurave që sigurohet në bazë të sigurimit në rast të papunësisë të përcaktuar me këto ligj,

- "treg i punës" është tregu në të cilin personat që kërkojnë punë dhe posedojnë njohuri, shkathtësi dhe përvojë punë takohen me punedhësit që kërkojnë kandidatë për vendet e lira të punës, ose lloje të caktuara të punëve për kompensim të caktuar në para (rroge) që do ta kontraktojnë ndërmjet veti,

- "zbatues i masave" është personi juridik ose fizik që i realizon masat aktive në tregun e punës të parapara me këto ligj ose ligj tjetër,

- "Agjencia për Punësim e Republikës së Maqedonisë" është institucion publik që jep mbështetje dhe ndihme dhe siguron shërbime për pjesëmarrësit në tregun e punës,

- "Agjencia për Ndermjëtesim për Punësim" është agjenci private për ndermjëtesim për punësim në vend dhe jashtë vendit, me arketim,

- "i huaj" është shtetas i shtetit që nuk është anëtar i Bashkimit Evropian, i shtetit që nuk është pale kontraktuese e Marrëveshjes për Hapësirën Ekonomike Evropiane dhe Konfederatës Zvicerane,

- "qytetar i Bashkimit Evropian" është qytetari i vendit anëtar të Bashkimit Evropian dhe anëtarët e familjes së tyre dhe qytetari i shtetit që është pale kontraktuese e Marrëveshjes së Hapësirës Ekonomike Evropiane dhe qytetari i Konfederatës Zvicerane dhe anëtarët e familjeve të tyre dhe

- "shërbim për ndermjëtesim për punësim me arketim" është aktiviteti i pavarur ekonomik, që kryen Agjencia e licencuar për ndermjëtesim për punësim, për të cilin merr kompensim financiar."

Neni 2

Në nenin 3 paragrafi 1 pas alinesë 3 shtohet aline e re 4, si vijon:

" - evidentimi i personave të tjerë që paraqiten në Agjenci, sipas kualifikimeve, njohurive dhe përvojave të tyre;"

Në alinën 5 pas fjaleve: "personit të papunësuar" shtohen fjalet: "dhe personit tjetër që kërkon punë".

Neni 3

Pas nenit 3 shtohet nen i ri 3-a, si vijon:

"Neni 3-a

Në planin individual për punësim që e përpilon Agjencia në bashkëpunim me personin e papunësuar përcaktohen qëllimet për punësim, plani i aktiviteteve të personit të papunësuar për punësim, pjesëmarrja në masat e politikave aktive për punësim dhe vendi i punësimit.

Planin individual për punësim e nënshkruajnë Agjencia dhe personi i papunësuar, në afat prej 30 ditësh nga dita e regjistrimit në Agjenci, me vlefshmeri prej gjashtë muajsh nga dita e nënshkrimit, afat pas të cilit behen ndryshime dhe plotësime të tij.

Afati për ndryshimet dhe plotësimet nga paragrafi 2 i këtij neni, fillon të rrjedhë 30 dite para skadimit të afatit prej gjashtë muajsh, e mbaron 30 dite pas skadimit të afatit prej gjashtë muajsh.

Nese personi i papunësuar nuk ndermerr veprime sipas paragrafit 3 të këtij neni, shlyhet nga evidenca e personave të papunësuar për periudhë prej një viti.

Për personat të tjerë që kërkojnë punë të evidentuar në Agjenci, Agjencia ofron shërbime të evidentimit dhe sigurimit të informatave për tregun e punës."

Neni 4

Neni 27 ndryshohet si vijon

"Agjenci për Ndermjëtesim për Punësim në vend dhe jashtë vendit me arketim, mund të themelojë personi fizik i cili:

- ka së paku arsimim të mesëm,

- nuk është në marrëdhënie punë,

- disponon me lokal afarist të vecantë të pershtatshëm minimal prej së paku 30m², dhe që i plotëson kushtet në pajtim me rregullat për siguri dhe shëndet gjatë punës,

- ka të punësuar së paku dy persona në kohë të pacaktuar dhe

- ka marrë licence për kryerjen e ndermjëtesimit për punësim nga ministria kompetente për çështjet e punës.

Personat të cilet punojnë në ndermjëtesim për punësim në Agjencinë për Ndermjëtesim për Punësim nga paragrafi 1 i këtij neni, duhet të kenë arsimim të lartë.

Themeluesi i Agjencisë për Ndermjëtesim për Punësim është edhe personi përgjegjës i Agjencisë për Ndermjëtesim për Punësim.

Të huajit mund t'i miratohet ndermjëtesim për punësim me arketim, vetëm nese me shtetin, shtetas i të cilit është ekzistencë reciprocitet në kryerjen e ndermjëtesimit për punësim me arketim.

Themeluesi i Agjencisë për Ndermjëtesim për Punësim nuk mund të jetë themeluesi apo pronari i shoqërisë tregtare, tregtari individual ose personi tjetër kryerës i veprimtarisë, as Agjencia për Ndermjëtesim për Punësim, nuk mund të jetë themeluesi i shoqërisë tregtare, e as të kryejë veprimtari tjetër përveç veprimtarisë së ndermjëtesimit për punësim."

Pas nenit 27 shtohen dy nene të reja 27-a dhe 27-b, si vijojnë:

"Neni 27-a

Licencën për kryerjen e ndermjëtesimit për punësim e leshon ministria kompetente për çështjet e punës, me propozim të komisionit të përbërë prej tre anëtarëve të emëruar nga ministri kompetent për çështjet e punës.

Licencën e leshon me vlefshmeri prej dy vitësh me mundësi për vazhdim për dy vjet, në bazë të kërkesës së themeluesit - personit përgjegjës të Agjencisë për Ndermjëtesim për Punësim, e pas mbikeqyrjes së kryer paraprakisht nga inspektori i punës për plotësim të kushteve nga neni 27 paragrafi 1 alinët 3 dhe 4 të këtij ligji.

Licenca për kryerjen e ndermjetesimit për punesim me arketim, perkatesisht për kryerjen e ndermjetesimit për punesim nuk mund t'i bartet në teresi ose pjeserisht personit fizik ose personit juridik dhe hiqet nese konstatohet se ndermjetesimi behet në kundershtrim me ligjin.

Licenca pushon të vlejë dhe Agjencise për Ndermjete-sim për Punesim shlyhet nga regjistri i agjencive për ndermjetesim për punesim me detyre zyrtare:

- me ditën e skadimit të vlefshmerise së licences dhe nuk eshte kerkuar vazhdimi i licences,

- nese ndodhin ndryshime në lidhje me kushtet për marrjen e licences giate punes së Agjencise për Ndermjete-sim për Punesim, e në afat prej pese ditesh Agjencia për Ndermjete-sim për Punesim nuk e njofton ministrine kompetente për ceshtjet e punes,

- nese ndermjetesimin për punesim e kryen në kundershtrim me kete ligj dhe ligj tjetër,

- kur nuk dorezon ekzemplar nga marrevshja e lidhur për ndermjetesim për punesim te inspektori i punes dhe Agjencia dhe

- kur Agjencia e ndryshon adresen dhe seline, e për ke-te në afat prej pese ditesh nuk e njofton ministrine kompetente për ceshtjet e punes, për ndryshime në regjistrin që e mban ministria kompetente për ceshtjet e punes.

Neni 27-b

Ministria kompetente për ceshtjet e punes mban Regjister të agjencive për kryerjen e ndermjetesimit për punesim me arketim në vend dhe jashte vendit.

Formen, permbajtjen dhe menyren e mbajtjes së Regjistrin nga paragrafi 1 i ketij neni, i percakton ministri kompetent për ceshtjet e punes.

Ministria kompetente për ceshtjet e punes kryen mbi-keqyrje mbi punen e agjencive për ndermjetesim për punesim nga paragrafi 1 i ketij neni.

Ministria kompetente për ceshtjet e punes kryen mbi-keqyrje të punes së Agjencive për Ndermjete-sim për punesim nga paragrafi 1 i ketij neni. Agjencia për Ndermjete-sim për Punesim nuk mund të filloje punen para marrjes së licences për kryerjen e ndermjetesimit për punesim dhe para regjistrimit në Regjistrin e agjencive për ndermjetesim për punesim në ministrine kompetente për ceshtjet e punes dhe në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonise. Me regjistrimin e Agjencise për Ndermjete-sim për Punesim në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonise, Agjencia për ndermjetesim për Punesim e merr cilesine e personit juridik.

Agjencia për Ndermjete-sim për Punesim regjistrohet në Regjistrin e agjencive për ndermjetesim për punesim, në baze të kerkeses së parashtuar me shkrim për regjistrim në regjister nga themeluesi - personi pergjegjes i Agjencise për Ndermjete-sim për Punesim, në të cilen shenohen emri dhe mbiemri i themeluesit – personit pergjegjes, numri unik amë i qytetarit, adresa dhe vendbanimi i themeluesit-personit pergjegjes, telefoni për kontakt dhe adresa elektronike e themeluesit-personit pergjegjes, titulli, adresa e Agjencise për Ndermjete-sim për Punesim, selia, telefoni për kontakt dhe adresa elektronike e Agjencise.

Me kerkesen për regjistrim në Regjistrin e agjencise për ndermjetesim për punesim, personi pergjegjes i agjencise dorezon deshmi për plotesimin e kushteve nga neni 27 paragrafi 1 i ketij ligji. Si deshmi për lokalin e siguruar afa-

rist themeluesi - personi pergjegjes dorezon deshmi për pronesi ose marrevshje për qira të verifikuar te noteri, ndersa si deshmi për personat e punesuar në agjenci parashtrohet ekzemplar të marrevshjes për punesim dhe formular M1/M2."

Neni 5

Në nenin 47 paragrafin 1 pas alinese 2 shtohet aline e re 3 si vijon:

- persona tjere të cilet kerkojne pune;

Neni 6

Në nenin 51 pas paragrafit 1 shtohen dy paragrafe të rinj 2 dhe 3, si vijojne:

"Punedhenesi detyrohet ta cregjistroje punetorin drejtperdrejt në Agjenci ose nepermjet sistemit elektronik të Agjencise më së voni tete dite nga dita e nderprerjes së marredhenies së punes.

Në rast kur punedhenesi nuk e cregjistroje punetorin në afatin nga paragrafi 2 i ketij neni, cregjistrimi behet me ditën e miratimit të dokumentacionit të nevojshem për cregjistrim të marredhenies së punes së punetorit."

Neni 7

Nentitulli 2. EVIDENCA E PERSONAVE TË PAPUNESUAR dhe nenet prej 52 deri në 61 ndryshohen, si vijojne:

"2. EVIDENCA E PERSONAVE TË PAPUNESUAR DHE PERSONAVE TJERE QË KERKOJNE PUNE

Neni 52

Agjencia mban evidence të personave të papunesuar dhe evidence të personave tjere që kerkojne pune, sipas numrit unik amë të qytetarit.

Neni 53

Person i papunesuar, sipas ketij ligji eshte personi i paraqitur në Agjenci, që eshte i papunesuar dhe në menyre aktive kerkon pune, eshte i afte të punoje dhe eshte i gats-hem të pranoje çdo punesim të volitshem ose pershtatshem që do t'ia ofroje Agjencia.

Person i papunesuar eshte edhe i huaji, që posedon leje personale për pune për të huaj deri në periudhen e vlefshmerise së saj dhe i huaji i cili në baze të marrevshjes së lidhur nderkombetare ose sipas parimit të reciprocitetit i ploteson kushtet për marrjen e kompensimit në para në rast të papunesise, derisa eshte shfrytezues i atij kompensimi.

Person i papunesuar eshte edhe personi që eshte në trajnim te punedhenesi, në kurs për arsimim ose në trajnim tjetër dhe për atë kohe e shfrytezon të drejten për kompensim në para për pergatitje për punesim, për kohen e shfrytezimit të kompensimit në para.

Si person i papunesuar, sipas ketij ligji nuk konsiderohet personi i cili eshte :

- në marredhenie pune,

- i vetepunesuar,

- pronar, themelues ose menaxhues i shoqerise tregtare dhe personit tjetër juridik ose eshte anetar i organit udheheqes, perkatesisht person i autorizuar në shoqeri tregtare dhe person tjetër juridik, pervec në shoqata dhe fondacione,

- kryeres i veprimtarise bujqesore, të blegtorise ose veprimtarise tjetere;

- kryeres i veprimtarise zejtare, perkatesisht profesionale,

- shfrytezuues i pensionit,

- që ka status të nxenesit në shkollë të mesme, student i rregullt, stazhier dhe personi që merr pjese në arsimim për të rritur, e është më ri se 26 vjet,

- i cili dy here gjate dy viteve ka refuzuar trajnim, riku-alifikim ose kualifikim shtese në të cilin do ta dergoje Agjencia,

- i cili dy here gjate dy viteve refuzon të paraqitet ose të themeloje marrëdhënie pune të punedhënes të i cili e ka derguar Agjencia dhe

- i cili është i angazhuar me pune ose kryen veprimtari, në kundërshtim me ligjin.

Kushtet nga paragrafi 1 i këtij neni, personi i papunësuar detyrohet t'i plotësojë gjate kohës derisa është në evidencën e personave të papunësuar.

Neni 54

Personi i afte për pune sipas këtij ligji konsiderohet personi i papunësuar në moshe prej 15 deri 65 vjet dhe personi i cili nuk është me pafatesi të përgjithshme, perkatesisht profesionale për pune, në pajtim me rregullat për sigurim pensional dhe invalidor për rehabilitim profesional dhe punësim të personave me invaliditet.

Personi i papunësuar i cili perkohësisht është i penguar për pune për shkak të problemeve me varesinë, shëndetin mental, probleme serioze sociale dhe probleme tjera shëndetësore të konstatuara në dokument nga komisioni kompetent i mjekëve, konsiderohet se perkohësisht nuk mund të punësohet. Pamundësia e perkohshme për punësim për shkakët e theksuara, si dhe të drejtat dhe obligimet e ketyre personave janë percaktuar në planin individual për punësim të personit të papunësuar në baze të ekzistimit të shkaqeve për pamundësi të perkohshme për punësim dhe masat e propozuara nga organi kompetent, në pajtim me ligjin.

Neni 55

Personi i papunësuar konsiderohet se në mënyrë aktive kërkon punë nese e plotëson një prej kushteve në vijim:

- rregullisht i ndjek vendet e lira të punës të shpallura dhe llojet e punës dhe në mënyrë perkatese paraqitet për të në pajtim me qellimet për punësim të percaktuara në planin individual për punësim,

- merr pjesë në intervista për punësim me kerkese të punedhënesit, Agjencisë ose realizuesve tjerë të masave për punësim,

- paraqitet në ftesa, njoftime dhe udhëzime nga Agjencia dhe realizues tjerë të masave për punësim dhe

- kontakton me klubet e punës në Agjenci dhe i plotëson aktivitetet e parapara nga obligimet e parapara në planin individual për punësim, së paku në afatet e percaktuara me kete ligj.

Neni 56

Personit të papunësuar mund t'i ofrohet punësim i pershtatshëm, i volitshëm dhe punësim tjetër.

Punësimi perkates mund t'i ofrohet personit të papunësuar në periudhë nga dita e futjes së personit në evidencën e personave të papunësuar deri në kalimin e 12 muajve nga

ajo dite. Agjencia mund të ofrojë punësim të pershtatshëm prej 12 muajsh deri në 24 muaj nga dita e futjes së personit në evidence.

Pas kalimit të 24 muajve nga futja në evidence, personit të papunësuar mund t'i ofrohet edhe vend tjetër i punës që nuk konsiderohet si i pershtatshëm ose i volitshëm, sipas këtij ligji.

Nese personi i papunësuar një here refuzon punësim të ofruar sipas paragrafeve 1 dhe 2 të këtij neni, i behet ve-rejtje nga Agjencia. Nese personi për here të dyte refuzon punësim të ofruar, me detyrë zyrtare evidentohet në listen e personave tjerë të evidentuar në Agjenci.

Personat shfrytezuues të ndihmes sociale në para dhe anetaret e familjeve të tyre krahas obligimeve nga paragrafet 1 dhe 2 të këtij neni, e kanë për obligim edhe të pranojnë angazhim në punë publike ose punë me interes publik, sipas kushteve të parapara me Ligjin për mbrojtje sociale, nese refuzon angazhim në punë publike ose punë me interes publik shlyhet nga evidence e personave të papunësuar.

Për personat shfrytezuues të ndihmes sociale në para dhe anetaret e familjeve të tyre afatet nga paragrafet 1 dhe 2 të këtij neni janë gjashtë dhe 12 muaj.

Neni 57

Si punësim perkates konsiderohet punësimi që i plotëson kushtet në vijim:

- në kohe të pacaktuar ose të caktuar me orar të plote ose më të shkurter nga orari i plote i punës, në pajtim me Ligjin për marrëdhënie pune ose rregullat për rehabilitim profesional dhe punësimi i personave me invaliditet,

- në vend pune që është në largësi më së shumti dy orë vozitje me transport publik ose transport të organizuar nga punedhënesi nga vendbanimi i personit deri në vendin e punës dhe mbrapa, perkatesisht një orë për person të papunësuar që jeton në mënyrë të pavarur me femije në moshe më të vogël se 15 vjet në kuader të familjes së perbashket dhe

- që është në pajtim me llojin dhe shkallën e arsimimit të mbaruar të personit dhe shkathtësite e fituara të shënuara në formularin e plotësuar, që e dergon në Agjenci për evidencim në evidencën e personave të papunësuar, nese personi për here të pare kërkon punë ose perseri kërkon punë pas pauzës në punësim prej së paku dy vitesh.

Me pelqim të personit të papunësuar, menjehere mund t'i ofrohet punë që është në nivel më të ulët të arsimimit dhe/ose kualifikimeve nga shkalla e arsimimit të mbaruar të personit dhe shkathtësite të fituara.

Neni 58

Si punësim i volitshëm konsiderohet punësimi:

- në kohe të pacaktuar ose të caktuar me orar më të shkurter nga orari i plote i punës, në pajtim me Ligjin për marrëdhënie pune ose rregullat për rehabilitim profesional dhe punësim të personave me invaliditet,

- në vend pune që është në largësi më së shumti dy orë vozitje me transport publik ose transport të organizuar nga punedhënesi nga vendbanimi i personit deri në vendin e punës dhe mbrapa, perkatesisht një orë për person të papunësuar që jeton në mënyrë të pavarur me femije në moshe më të vogël se 15 vjet në kuader të familjes së perbashket dhe

- për të cilin nevojitet arsimim ose shkathtesi të cilat janë më së shumti një shkallë më të uleta nga arsimimi ose shkathtesite e personit, të shenuara në formularin e plotësuar që e dorezon në Agjenci, për evidentim në evidencen e personave të papunësuar.

3. MENYRA E MBAJTJES SË EVIDENCES, REGJISTRIMI DHE SHLYERJA E PERSONIT NGA EVIDENCA

Neni 59

Personi i papunësuar dhe personi që kërkon punë personalisht ose nepermjet sistemit elektronik të Agjencise paraqitet në Agjenci, në rajonin e së ciles ka vendbanim të perhershëm, për futje në evidencen e personave të papunësuar ose në evidencen e personave tjere që kerkojne punë, me deklarate të personit në formular të vecante se në cilën evidence dëshiron të evidentohet, në pajtim me kete ligj dhe aktin nga neni 61 paragrafi 2 i ketij ligji.

Personit pergjegjies në Agjenci, i cili do të mundesoje paraqitje të personit të papunësuar dhe personit tjetër që kërkon punë në kundershtim me paragrafin 1 të ketij neni, do t'i prishet marreveshja për punësim për shkak të kryerjes së pandergjegjshme të obligimeve të punës dhe mosrespektimit të rregullave që vlejne për kryerjen e punëve në vendin e punës.

Personi i papunësuar që shfrytëzon të drejten për kompensim në para detyrohet që personalisht të paraqitet në Agjenci, në çdo 30 dite dhe të dëshmoje se në menyre aktive ka kërkuar punë në muajin e fundit.

E drejta e pageses së kompensimit në para me kerkese të personit të papunësuar mund të pezullohet në rast kur:

- qendron jashte Republikës së Maqedonise më shume se 30 dite për bashkim familjar, por jo më shume se 90 dite dhe

- qendron jashte Republikës së Maqedonise për mjekim ose ndihme dhe perkujdesje nga anetari i familjes më të ngushte më shume se 30 dite, por jo më shume se 90 dite.

Neni 59-a

Personi i papunësuar detyrohet që personalisht të paraqitet në Agjenci, në çdo 30 dite dhe të dëshmoje se në menyre aktive ka kërkuar punë në muajin e fundit, ndersa personi tjetër i cili kërkon punë në çdo gjashte muaj.

Personi i papunësuar që nuk do ta permbushë obligimin nga paragrafi 1 i ketij neni në afat prej 30 ditësh pas kalimit të afatit të paraqitjes të percaktuar në planin individual për punësim, shlyhet nga evidencia e personave të papunësuar dhe perseri mund të paraqitet pas kalimit të një viti, ndersa shfrytëzuesit e të drejtave në baze të papunësisë e humbin edhe të drejten.

Personi i papunësuar i cili nga Agjencia është derguar të punedhenesi për punësim dhe nuk paraqitet ose refuzon të themeloje marrëdhënie punë në punësim të perkates apo të volitshëm, në pajtim me kete ligj ose refuzon trajnim, rikualifikim ose kualifikim shtese për punësim, shlyhet nga evidencia e personave të papunësuar dhe perseri mund të paraqitet pas kalimit të një viti.

Personi i papunësuar i cili nuk i respekton obligimet e marra në planin individual për punësim, shlyhet nga evidencia e personave të papunësuar dhe perseri mund të paraqitet pas kalimit të një viti.

Personi i cili nuk do të pranoje trajnim dy here gjate dy viteve shlyhet nga evidencia e personave të papunësuar. Personi i papunësuar i cili nuk do ta njoftoje Agjencine për ndryshimet që ndikojne për marrjen ose humbjen e të drejtave, e nga organi inspektues zihet duke punuar në kundershtim me ligjin ose refuzon angazhim me punë për kryerjen e punëve publike, shlyhet nga evidencia e personave të papunësuar dhe perseri mund të paraqitet pas kalimit të një viti. Organi inspektues për keta persona detyrohet që me shkrim ta njoftoje Qendren për Punë Sociale dhe Agjencine.

Personi i papunësuar, i cili nga organi inspektues do të zihet duke punuar në kundershtim me ligjin kryen kundervajtje.

Neni 59-b

Agjencite për ndermjetesim për punësim në vend dhe jashte vendit me arketim dhe Agjencite për punësim të perkohshme kane trajtim të njejte me Agjencine në ndermjetesim për punësim dhe qasje në bazen e personave të papunësuar për zgjedhje të kandidatëve për punësim.

Neni 60

Në perpunimin e të dhenave dhe në mbrojtjen dhe shfrytëzimin e të dhenave të permbajtura në evidence zbatohen dispozitat e ligjit me të cilin rregullohet mbrojtja e të dhenave personale.

Evidenca, e percaktuar me kete ligj, mbahet me qellim të miratimit të aktvendimeve për të drejten e sigurimit në baze të papunësisë, për ofrimin e sherbimeve dhe pjesëmarrje në masat e politikave aktive për punësim, perpilimin e planit për punësim, kryerjen e mbikeqyrjes në pajtim me kete ligj, për ndjekje, planifikim dhe zbatim të politikës në sferat e percaktuara me kete ligj, si dhe për hulumtime shkencore dhe qellime statistikore.

Neni 61

Agjencia i mban regjistrat në vijim të:

- personave të papunësuar të evidentuar,
- personave të evidentuar me pamundësi të perkohshme për punësim,
- pjesëmarrësve në programe të politikave aktive për punësim,
- personave tjere të evidentuar që kerkojne punë dhe
- shfrytëzuesve të mjeteve publike nga Agjencia dhe realizuesve të masave të parapara me kete ligj dhe ligj tjetër.

Formen, permbajtjen dhe menyren e mbajtjes së regjistrave nga paragrafi 1 i ketij neni, i percakton ministri kompetent për ceshtjet nga sfera e punës.

Neni 61-a

Regjistri i personave të papunësuar të evidentuar, regjistri i personave të evidentuar me pamundësi të perkohshme për punësim, regjistri i pjesëmarrësve në programe të politikave aktive për punësim, regjistri i personave tjere të evidentuar që kerkojne punë dhe regjistri i shfrytëzuesve të mjeteve publike nga Agjencia dhe realizuesve të masave të parapara me kete ligj dhe ligj tjetër, detyrimisht i permban të dhenat në vijim:

- emrin dhe mbiemrin,
- datelindjen,

- gjinine,
- numrin unik amë të qytetarit (NUAQ),
- numrin tatimor të Agjencive të licencuara dhe realizuesve të masave aktive për punesim,
 - adresen e vendbanimit të perhershëm ose të perkohshëm (në vende tjera edhe kodin shtetëror),
 - shtetësinë,
 - statusin (nxenes në shkolle të mesme, student, i punësuar, i vetëpunësuar, pensionist, bujk – nese personi pronkohet),
 - perkatesine e bashkësisë etnike,
 - numrin e llogarise së transaksionit,
 - numrin e telefonit ose posten elektronike për kontakt,
 - arsimimin, kualifikimet profesionale, shkathtësite, kualifikimet shtese dhe përvonjen e punes,
 - aftësinë për punë dhe kufizimet,
 - periudhen e sigurimit dhe
 - periudhen e punesimit.

Pervec të dhenave të perbashketa, evidencat nga paragrafi 1 i këtij neni i permbajne edhe të dhenat në vijim:

1) Regjistri i personave të papunësuar:

- paraqitjen, mbajtjen në evidence dhe shlyerjen nga evidencia,
- shkakun për shlyerje nga evidencia,
- permbushjen e obligimeve që dalin nga statusi i personit të papunësuar sipas këtij ligji (njoftime, dergime, permbushje të obligimeve tjera),
- bazen për kompensim në rast të papunësisë,
- periudhen dhe lartësinë e kompensimit në baze të papunësisë,
- llojin dhe lartësinë e kompensimit në baze të papunësisë,
- periudhen në të cilën pranohet ndihma sociale në para nga Qendra për Punë Sociale,
- llojin, kohezgjatjen dhe dhenesin e sherbimit, të perkaktuar me kete ligj,
- kerkesen për kthim të mjeteve të pranuar në menyre të parregullt dhe menyren e kthimit,
- ankesat dhe
- fillimin dhe fundin e procedures gjyqesore në të cilën personi i perfshire eshte pale në lidhje me zbatimin e dispozitave të këtij ligji (lloji i procedures gjyqesore, lenda e kontestit, numri i dergimit, njoftimi për rezultatin e gjykimit).

2) Regjistri i personave me pamundësi të perkohshme për punësim:

- paraqitjen, mbajtjen në evidence dhe shlyerjen nga evidencia,
- shkaqet për shlyerje nga evidencia,
- periudhen e pamundësisë për punësim,
- daten e shqyrtimit të pamundësisë për punësim nga organi kompetent në pajtim me ligjin dhe
- propozim-masat e organit kompetent për percaktim të pamundësisë së perkohshme për punësim.

3) Regjistri i personave të cilet marrin pjese në programa për politika aktive për punësim:

- paraqitjen, mbajtjen në evidence dhe shlyerjen nga evidencia,
- shkaqet për shlyerje nga evidencia,
- llojin, kohezgjatjen dhe dhenesin e sherbimit, të perkaktuar me kete ligj,

- perkatesine në grup të caktuar qellimor,
- mjetet e shpenzuara financiare,
- suksesin në programin e zbatuar,
- permbushjen e obligimeve kontraktuese nga personi i perfshire,
- kerkesat për kthim të mjeteve të pranuar në menyre të parregullt dhe menyra e kthimit,
- ankesat dhe
- fillimin dhe fundin e procedures gjyqesore në të cilën personi i perfshire eshte pale në lidhje me zbatimin e dispozitave të këtij ligji (lloji i procedures gjyqesore, lenda e kontestit, numri i dergimit, njoftimi për rezultatin e gjykimit).

4) Regjistri i personave tjere të cilet kerkojne pune:

- paraqitjen, mbajtjen në evidence dhe shlyerjen nga evidencia,
- shkaqet për shlyerje nga evidencia,
- llojin, kohezgjatjen dhe dhenesin e sherbimit, të perkaktuar me kete ligj,
- llojin dhe lartësinë e kompensimeve në para për të cilat ka të drejte personi që kerkon punë, sipas dispozitave të këtij ligji,
- për personat që kerkojne punë, e marredhenia e punes e të cileve eshte në rrezik, emrin dhe leshuesin e dokumentit me të cilin vertetohet se marredhenia e punes e punetorit eshte në rrezik (planin afarist të punedhënesit, programet për teprice teknologjike, vendimin për nderprerje të marredhënesisë së punes për shkaqe afariste (teknologjike, ekonomike, organizative e ngjashem), njoftim nga likuiduesi ose drejtori i falimentimit për periudhe kohore në të cilën planifikohet që punetorit t'i nderpritet marredhenia e punes për shkaqe afariste) dhe
- për personat në marredhenie pune në kohe të caktuar të cilet kerkojne punë, e marredhenia e punes e të cileve eshte në rrezik, data e skadimit të vlefshmerise së marrevshjes në kohe të caktuar.

5) Regjistri i shfrytezuesve të mjeteve publike nga Agjencia dhe realizuesve të masave të parapara me kete ligj dhe ligj tjetër, i permban informatat në vijim:

- emrin e regjistruar dhe seline ose emrin dhe adresen e subjektit afarist,
- numrin e regjistrimit të subjektit afarist,
- numrin tatimor të subjektit afarist,
- emrin dhe mbiemrin e personit pergjegjes në subjektin afarist,
- bazen juridike për pagesen e mjeteve (marrevshje, urdherese për furnizim etj.),
- shumen dhe dedikimin e mjeteve të paguara,
- daten e mbikeqyrjes,
- kerkesat për kthim të shumave të pranuar në menyre të parregullt dhe të shfrytezuara dhe menyren e kthimit,
- daten e kerkeses për kthim,
- ankesat,
- fillimin dhe fundin i procedures gjyqesore në të cilën personi i perfshire eshte pale në lidhje me zbatimin e dispozitave të këtij ligji (lloji i procedures gjyqesore, lenda e kontestit, numri i dergimit dhe njoftimi lidhur me rezultatin e gjykimit) dhe
- informaten për rregullshmerine e pageses së rrogave dhe pagesave të kontributeve nga sigurimi i detyrueshem social nga punedhënesi.

Personat e futur në evidence sipas ketij ligji, detyrohen ta njoftojne Agjencine nese ndodh ndonje ndryshim në informatat, e cila do të ndikonte mbi plotesimin e kushteve në të cilat, personat mbahen në evidence ose mbi shlyerjen nga evidenca, më së voni tete dite nga dita e krijimit të ndryshimit.

Neni 61-b

Agjencia i grumbullon të dhenat e nevojshme për realizimin e kompetencave të veta, të percaktuara me ligj, drejtperdrejt nga personi me të cilin kane të bejne të dhenat dhe nga evidencat të cilat mbahen në organet në vijim: Drejtoria e të Hyrave Publike, Fondi për Sigurim Shendetesor i Maqedonise, Fondi për Sigurim Pensional dhe Invalidor i Maqedonise, Qendrat për Pune Sociale, Inspektorati Shtetor i Punes, Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonise, Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonise dhe organe dhe institucione tjera të cilat mbajne evidence, të percaktuara ose të mbajtura në baze të ligjit, e të cilat nevojiten për realizimin e kompetencave të Agjencise.

Agjencia mund t'i lidhe evidencat, të cilat mbahen në pajtim me kete ligj, me evidencat të cilat i mbajne organet e theksuara nga paragrafi 1 i ketij neni.

Me qellim të zbatimit të masave, realizuesit e masave aktive mund të marrin nga Agjencia informata për atë nese ndonje person eshte regjistruar në regjistrin e personave të papunesuar dhe të dhena tjera të nevojshme për zbatimin e masave, si dhe të dhena personale të cilat kane të bejne me qellimin e zbatimit të masave.

Shfrytezuesit e të drejtave në baze të ketij ligji, detyrohen që ta njoftojne Agjencine dhe realizuesit tjere të masave për të gjitha ndryshimet të cilat ndikojne mbi marrjen, heqjen ose humbjen e të drejtave, më së voni tete dite pas krijimit të ndryshimit.

Neni 61-v

Agjencia mund t'u barte organeve të administrates dhe organeve tjera shtetore, organeve të njesive të vetadministrimit lokal, të dhena personale nga evidenca, e cila mbahet sipas ketij ligji, me qellim të realizimit të kompetencave të percaktuara me ligj, me kusht që ligji të percaktoje grumbullimin e të dhenave personale nga Agjencia, në pajtim me rregullat për mbrojtjen e të dhenave personale.

Qasja në të dhenat nga personat prej të cileve jane marre të njejtat, obligimi për dorezimin e ndryshimit të të dhenave personale dhe korrigjimi i të dhenave personale, kryhet në pajtim me rregullat për mbrojtjen e të dhenave personale.

Neni 61-g

Të dhenat ruhen:

- në regjistrin e personave të papunesuar të evidentuar: 50 vite pas futjes së të dhenave,
- në regjistrin e personave të evidentuar të papunesuar perkohesisht: pese vite pas futjes së të dhenave,

- në regjistrin e personave të cilet marrin pjese në programe për politika aktive për punesim: dhjete vite pas futjes së të dhenave,

- në regjistrin e personave të evidentuar të cilet kerkojne pune: pese vite pas futjes së të dhenave dhe

- në regjistrin e shfrytezuesve të mjeteve publike të Agjencise dhe realizuesve të masave të parapara me kete ligj ose ligj tjeter: dhjete vite pas futjes së të dhenave.

Pas skadimit të afateve të theksuara në paragrafin 1 të ketij neni, me të dhenat veprohet në pajtim me rregullat me të cilat rregullohet veprimi i organeve kompetente për veprim dhe ruajtje të materialit arkivor dhe materialeve dokumentare.

Neni 61-d

Personi i papunesuar futet në regjistrin e personave të cilet marrin pjese në programe për politike aktive për punesim në baze të marreveshjes për pjesemarrje në program ose në baze të dergimit nga Agjencia.

Neni 61-gj

Agjencia e shlyen personin nga regjistri i personave të papunesuar ose nga regjistri i personave të cilet marrin pjese në programe për politike aktive për punesim nese personi:

- tanime nuk eshte i papunesuar, sipas dispozitave të ketij ligji,

- vete cregjistrohet nga regjistri i personave të papunesuar ose nga regjistri i personave të cilet marrin pjese në programe për politike aktive për punesim,

- nuk paraqitet në afatin e percaktuar ose nuk paraqitet me ftese të Agjencise për shkaqe të paarsyeshme,

- nuk e njofton Agjencine për marrjen ose humbjen e të drejtave,

- refuzon të perfshihet në program për politike aktive për punesim ose nuk i permbush obligimet nga marreveshja për pjesemarrje në program për politike aktive për punesim,

- refuzon punesim perkates ose të volitshem ose refuzon të jete i pranishem në intervista për punesim ose nuk shpreh interes për prani në intervista për pune,

- nuk siguron të dhena të sakta për marrjen e statusit të personit të papunesuar ose statusit të pjesemarrjes në program për politike aktive për punesim,

- te personi konstatohet ekzistim i shkakut për të cilin personi perkohesisht nuk mund të punesohet,

- eshte në paraburgim në kohezgjatje prej më shume se gjashte muajsh ose nese personi fillon ta vuaje denimin me burg prej gjashte muajsh e më shume,

- nga organi inspektues, personi zihet duke punuar në kundershtim me ligjin,

- nuk kerkon pune në menyre aktive,

- refuzon të nenshkruaje plan individual për punesim në pajtim me kete ligj,

- i ploteson kushtet për pension,

- të huajit i kalon vlefshmeria e lejes personale për pune,

- fillon të kryeje pune zejtare, bujqesore, të blegtorise ose veprimtari tjetër,

- refuzon angazhim me pune për kryerjen e puneve publike dhe

- shkon në kryerjen e sherbimit ushtarak vullnetar.

Pjesemarrja në programe për politike aktive për punesim nuk është shkak për shlyerje nga regjistri i personave të papunësuar, por në rast kur personi merr pjesë në program për politike aktive për punesim, që shpie në lidhjen e marrëveshjes për punesim, personi qendron në regjistrin e personave të cilet marrin pjesë në program për politike aktive për punesim.

Neni 61-e

Agjencia e shlyen personin nga regjistri i personave të papunësuar ose nga regjistri i personave të cilet marrin pjesë në programe për politike aktive për punesim, me detyrë zyrtare me ditën e krijimit të ndonjerit prej shkaqeve të nenit 61-gj të këtij ligji.

Nese personi merr pjesë në programe për politike aktive për punesim, zbatimi i programeve mbikeqyret deri në skadimin e marrëveshjes për pjesëmarrje në program ose deri në perfundimin e procedurës për kthimin e mjeteve, në pajtim me marrëveshjen për pjesëmarrje në program edhe krahas shlyerjes nga evidenca.

Neni 61-zh

Agjencia e shlyen nga regjistri personin i cili kërkon pune, nese:

- cregjistrohet nga regjistri dhe

- nuk vendos kontakt me Agjencinë në afat prej gjashtë muajsh pas paraqitjes. "

Neni 8

Agjencite ekzistuese për ndermjetesim për punesim, detyrohen ta harmonizojne punën e tyre me kete ligj në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të aktit nga neni 27-b paragrafi 2 të këtij ligji.

Neni 9

Neni 75 paragrafi 1 ndryshohet si vijon:

"Pagesa e kompensimit me para për personin e papunësuar nderpritet gjate:

- kryerjes së sherbimit ushtarak vullnetar,

- derisa është në paraburgim ose vuan dënim me burg deri në gjashtë muaj,

- derisa personi i papunësuar perkoheishtë qendron jashtë Republikës së Maqedonisë deri në 12 muaj, e paraqishtë me shkrim e ka njoftuar Agjencinë,

- angazhimin me pune mbi 30 dite për kryerjen e puneve publike dhe

- është i angazhuar me pune ose kryen veprimtari."

Neni 10

Në nenin 100 pas paragrafit 2 shtohet paragrafi i ri 3, si vijon:

"Gjohet në shume prej 200 eurosh në kundërvlerë me denare, do t'i kumtohet për kundërvajtje aty për aty personit të papunësuar, i cili nga organi inspektues do të zihet duke punuar në kundërshtim me ligjin (neni 59-a paragrafi 6)."

Paragrafi 3 behet paragrafi 4.

Neni 11

Aktet nenligjore nga nenet 61 paragrafi 2 dhe 27-b paragrafi 2 të këtij ligji do të miratohen në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

Ligji për evidencën nga sfera e punës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numer 16/2004, 102/2008 dhe 17/11) dhe Rregullorja për mbajtjen e evidencës në sferën e punës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numer 16/2004, 102/2008 dhe 15/2009) do të harmonizohen me dispozitat e këtij ligji në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 12

Autorizohet Komisioni Juridik Ligjvenes i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë që të percaktojë tekst të spastruar të Ligjit për punesim dhe sigurim në rast të papunesisë.

Neni 13

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tete nga dita e botimit në "Gazeten Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa do të fillojë të zbatohet pas kalimit të tre muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

2902.

Врз основа на членот 75 ставови 1 и 2 од Уставот на Република Македонија, претседателот на Република Македонија и претседателот на Собранието на Република Македонија издаваат

У К А З

ЗА ПРОГЛАСУВАЊЕ НА ЗАВРШНАТА СМЕТКА НА БУЏЕТОТ НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА ЗА 2011 ГОДИНА

Се прогласува Завршната сметка на Буџетот на Република Македонија за 2011 година,

што Собранието на Република Македонија ја донесе на седницата одржана на 12 септември 2012 година.

Бр. 07-3898/1

12 септември 2012 година на Република Македонија,
Скопје

Претседател

Ѓорге Иванов, с.р.

Претседател

на Собранието на Република
Македонија,

Трајко Вељаноски, с.р.